

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 419, datë 25.6.2014 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A, B, dhe C, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKB-JA”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektvendimit është harmonizimi i projektvendimit me parashikimet në Kodin e Procedurës Administrative në kuadër të përmirësimit të procedurës për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A dhe B, saktësimi dhe eliminimi i parashikimeve në lidhje me lejet e mjedisit të tipit C, tashmë të shfuqizuara me ndryshimet ligjore të vitit 2020, në ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar; si dhe përditësimi i termave dhe organeve të përdorur në përmbajtjen e projektvendimit, në funksion të teknikës legjislativë.

Nëpërmjet ndryshimit të këtij projektvendimi synohet ndërhyrja dhe saktësimi në strukturën e projektvendimit të dispozitave mbi sistemin e lejeve të mjedisit, duke e përditësuar atë, në bazë të ligjit të ndryshuar nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar, nga një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, tipi A, B apo C, në një sistem vetëm me dy nivele të lejeve të mjedisit, përkatësisht leje të tipit A dhe B, duke eliminuar kështu lejet e mjedisit të tipit C, tashmë të shfuqizuara. Gjithashtu rishikimi i procedurës për shqyrtimin e

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në VKM 419, datë 17.7.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”.

kërkesave synon lehtësimin e cdo subjekti që aplikon për leje mjedisi të tipit A dhe B, duke i lënë hapësirë në rast parregullësish, të plotësojë dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit, pa kosto shtesë financiare si dhe të pajiset me leje mjedisi brenda afateve më të reduktuara. Në kuadër të ristrukturimit të institucioneve të varësisë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, konkretisht shkrirja e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave si dhe përditësimit të termave të organeve inspektuese, janë bërë ndryshimet përkatëse kudo në strukturën e projektvendimit, në funksion të teknikës legjislative.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KESHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve, për vitin 2023, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet e propozuara lehtësojnë ndjeshëm, si në procedurë dhe në kohë, por mbi të gjitha në koston financiare subjektet pas unifikimit me Kodin e Procedurave Administrative ku parashikohet të amendohen ato pika, të cilat trajtojnë afatatet për plotësim dokumentacioni dhe subjektet nuk do të detyrohen të rikryejnë me pagesën përkatëse të lejes së mjedisit në rast të refuzimit për mungesë dokumentacioni.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMERISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në VKM 419, datë 17.7.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”.

Ndryshimi i projektvendimit të sipërcituar bëhet në përputhje me parashikimet e Programit Analitik të Projektakteve, për vitin 2023.

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe në harmonizim me ligjin nr. 10448, datë 14.10.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar, ligjin nr. 10431, datë 09.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe lidhet me strategjinë ndërsektorale të mjedisit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ndryshimet e propozuara në projektakt nuk transpozojnë akte të Bashkimit Evropian.

VI. PERMBLEDHJE SHPJEGUESE E PERMBAJTJES SE PROJEKTAKTIT.

Projektvendimi synon lehtësimin e cdo subjekti që aplikon për leje mjedisi të tipit A dhe B, nëpërmjet:

- a) parashikimit dhe përcaktimit të një procedurë për shqyrtimin e kërkesave të harmonizuara me Kodin e Procedurave Administrative, duke i lënë hapësirë në rast parregullësish, të plotësojë dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit, pa kosto shtesë financiare si dhe të pajiset me leje mjedisi brenda afateve më të reduktuara;
- b) të përcaktojë reflektimet e ndryshimeve, sipas ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, duke e përditësuar në aspektin e sistemit të ri të lejeve të mjedisit të përbërë vetëm me dy nivele të lejeve të mjedisit, përkatësisht leje të tipit A dhe B, duke eliminuar kështu lejet e mjedisit të tipit C si dhe reflektimin e ndryshimit të organeve inspektuese, referuar ristrukturimit të institucioneve të varësisë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përkatësisht shkrirja e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave si dhe saktësimi i termave të organeve si QKL-ja, Ministria e Mjedisit.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në VKM 419, datë 17.7.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”.

Konkretisht në vendimin nr. 419, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 1 të projektvendimit parashikohet që në titull dhe kudo në përmbajtjen e vendimit ekzistues, fjalët “leje mjedisi të tipave A, B dhe C” të zëvendësohen me fjalët “leje mjedisi të tipit A dhe B”, pasi leja e tipit C është eliminuar nga sistemi i lejeve të mjedisit.

Në pikën 2 janë parashikuar ndryshimet përkatëse kudo në përmbajtjen e vendimit ekzistues që kanë të bëjnë me heqjen e organit inspektues që nuk është më “ISHMPU”, pasi tashmë është shndërruar në degë drejtorie pranë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit; saktësimi i termit “ministria e mjedisit” që do të jetë “ministria përgjegjëse për mjedisin” si dhe zëvendësimi në përmbajtje të vendimit ekzistues të fjalëve “neneve 30 dhe 31 të ligjit” me fjalët “nenin 30 të ligjit”, pasi ky nen është shfuqizuar në ligjin përkatës “Për lejet e mjedisit”.

Në pikën 3 të projektvendimit janë parashikuar disa shtesa dhe ndryshime në kreun II të vendimit ekzistues. Përkatësisht gërma “a” e projektvendimit parashikon ndryshimin e pikës 1, të kreut II, të vendimit ekzistues, duke saktësuar mënyrën e aplikimit për leje mjedisi të tipit A, nga kërkuesi, si më poshtë vijon:

“1. Kërkuesi që aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nëpërmjet portalit e-albania, për pajisjen me leje mjedisi të tipit A, duhet të dorëzojë këto dokumente:”

Gërma “b” shfuqizon pikën “c” të kreut II të vendimit ekzistues, sepse sjell vështirësi dhe mbingarkesë të panevojshme dokumentacioni, në shqyrtimin e kërkesës nga institucioni përgjegjës. Nërkohë që gërma “c” e projektvendimit parashikon shtimin e dy pikave konkretisht 1.2 dhe 1.3 në vendimin ekzistues duke parashikuar në këto dispozita, një fazë paraprake lehtësuese, për subjektin që aplikon për leje mjedisi të tipit A, me këtë përmbajtje:

1.2. AKM brenda 7(shtatë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga QKB-ja për leje mjedisi të tipit A, shqyrton kërkesën dhe verifikon nëse dokumentacioni është depozituar saktë dhe i plotë sipas pikës 1, të këtij kreu. Në

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në VKM 419, datë 17.7.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”.

rast se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, AKM konstaton se dokumentacioni i depozituar, nga kërkuesi nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit e-Albania, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara, brenda 10(dhjetë) ditëve nga dita e njoftimit.

1.3. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila në këtë rast quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit “e-Albania” për arsyet e mospranimit dhe aplikimi i kthehet bashkë me aktet e tjera.

Gërma “ç” parashikon ndryshimet në pikat 2, 3 dhe 4 të vendimit ekzistues, konkretisht shtimin e institucioneve të cilat bëhen pjesë e procesit të dhënies së mendimit mbi dokumentacionin për dhënie leje mjedisi si dhe vendosjen e afateve më të reduktuara në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për leje mjedisi, si më poshtë vijon:

2. AKM kur vlerëson se dokumentacioni është i plotë sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 7 (shtatë) ditëve, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 7 (shtatë) ditëve pune:

a) Drejtorive teknike në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, sipas specifikave të instalimit;

b) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM).

c) Ministrive të linjës dhe strukturave të varësisë, rast pas rasti, sipas fushës së veprimtarisë që lidhen me specifikat e instalimit;

ç) Njësitë e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit territorial ku ndodhet instalimi.

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 5 të këtij kreu nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën e shqyrtimit të kërkesës për leje të mjedisit të tipit A.

4. AKM-ja pas mbledhjes së mendimeve nga institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij kreu ose pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, harton brenda 10(dhjetë)ditëve pune aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në VKM 419, datë 17.7.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”.

lejes së mjedisit të tipit A, të shoqëruar me argumentet përkatëse dhe e dërgon tek ministri.

Në gërmën “d”, parashikohet ndryshimi në pikën 6 në vendimin ekzistues ku togfjalëshi “brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim” do të zëvendësohet me togfjalëshin “brenda 2 (dy) ditëve nga data e marrjes dijani së aktit të miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit A. Ndërsa në gërmën “dh”, parashikohet që në pikën 12 të vendimit ekzistues të reduktohet afati total i shqyrtimit të kërkesës për leje mjedisi të tipit A, konkretisht togfjalëshi “është 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune” do të zëvendësohet me “ është 43 (dyzetë e tre) ditë pune”.

Në pikën 4, parashikohen disa shtesa dhe ndryshime në kreun III të vendimit ekzistues. Përkatësisht gërma “a” e projektvendimit parashikon ndryshimin e pikës 1, të kreut III, të vendimit ekzistues, duke saktësuar mënyrën e aplikimit për leje mjedisi të tipit B, nga kërkuesi, si më poshtë vijon:

“1. Kërkuesi që aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nëpërmjet portalit e-albania, për pajisjen me leje mjedisi të tipit B, duhet të dorëzojë këto dokumente:”

Gërma “b”, parashikon shfuqizimin e pikës “c” të kreut III të vendimit ekzistues, sepse sjell vështirësi dhe mbingarkesë të panevojshme dokumentacioni në shqyrtimin e kërkesës nga institucioni përgjegjës. Nërkohë që gërma “c”, parashikon shtimin e dy pikave konkretisht 1.2 dhe 1.3 në vendimin ekzistues duke parashikuar në këto dispozita një fazë paraprake lehtësuese për subjektin që aplikon për leje mjedisi të tipit B, me këtë përmbajtje:

1.2. AKM brenda 5(pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga QKB-ja për leje mjedisi të tipit B, shqyrton kërkesën dhe verifikon nëse dokumentacioni është depozituar saktë dhe i plotë sipas pikës 1, të këtij kreu. Në rast se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, AKM konstaton se dokumentacioni i depozituar, nga kërkuesi nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit e-Albania, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e njoftimit.

1.3. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila në këtë rast quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit “e-

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në VKM 419, datë 17.7.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”.

Albania” për arsyet e mospranimimit dhe aplikimi i kthehet bashkë me aktet e tjera.

Gërma “ç” parashikon ndryshimet në pikat 2, 3 dhe 4 të vendimit ekzistues, konkretisht shtimin e institucioneve të cilat bëhen pjesë e procesit të dhënies së mendimit mbi dokumentacionin për dhënie leje mjedisi si dhe vendosjen e afateve më të reduktuara në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për leje mjedisi, si më poshtë vijon:

2. AKM kur vlerëson se dokumentacioni është i plotë sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 5 (pesë) ditëve, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 5 (pesë) ditëve pune:

a) Drejtorive teknike në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, sipas specifikave të instalimit;

b) Strukturave përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit ;

c) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM);

c) Ministrive të linjës dhe strukturave të varësisë, rast pas rasti, sipas fushës së veprimtarisë që lidhen me specifikat e instalimit;

ç) Njësitë e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit territorial ku ndodhet instalimi.

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 5 të këtij kreu nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën e shqyrtimit të kërkesës për leje të mjedisit të tipit A.

4. AKM-ja pas mbledhjes së mendimeve nga institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij kreu ose pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, harton brenda 10(dhjetë) ditëve pune aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse dhe e dërgon tek ministri.

Në gërmën “d”, parashikohet ndryshimi në pikën 6 në vendimin ekzistues, ku togfjalëshi “brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim” do të zëvendësohet me togfjalëshin “brenda 2 (dy) ditëve nga data e marrjes dijani së aktit të miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit B”.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në VKM 419, datë 17.7.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”.

Ndërsa në gërmën "dh", parashikohet që në pikën 12 të vendimit ekzistues të reduktohet afati total i shqyrtimit të kërkesës për leje mjedisi të tipit B, konkretisht tofjalëshi "është 40 (dyzet) ditë pune do të zëvendësohet me " është 32 (tridhjetë e dy) ditë pune".

Në pikën 5, shfuqizohet kreu IV i vendimit ekzistues, që përcakton procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimin e kushteve për leje mjedisi të tipit C, tashmë të shfuqizuara.

Në pikën 6, shfuqizohet gërma "c" e pikës 2, e seksionit 2, të kreut V, që përcakton afatin për rishikimin e kushteve të lejes së mjedisit të tipit C, tashmë të shfuqizuara.

Në pikën 7, parashikohen parashikohen ndryshime në kreun VI përkatësisht në pikat 1 dhe 3 të vendimit ekzistues, konkretisht në saktësimin e formës së dërgimit të njoftimit nga kërkuesi (elektronikisht) dhe reduktimin e afatit të publikimit të njoftimit, menjëherë nga ana e AKM, si më poshtë vijon:

"1. Kërkuesi, përpara aplikimit në QKB, dërgon në AKM, në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) ku do të ketë vendndodhjen instalimi, një njoftim, me shkrim dhe në formë elektronike, për aplikimin që do të kryejë për t'u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B."

"3. AKM-ja publikon menjëherë, në faqen e saj të internetit, njoftimin sipas pikës 2 të këtij kreu, për të paktën 20 (njëzet) ditë pune."

Në pikën 8, shfuqizohen pikat 2, 5, 7 dhe 9 të kreut VIII të vendimit ekzistues, që përcaktojnë dispozitat përfundimtare për lejet e mjedisit të tipit C, tashmë të shfuqizuara.

Në pikën 9, shfuqizohet shtojca 3, që përcakton formularin informues për lejet e mjedisit të tipit C, tashmë të shfuqizuara.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QE NGARKOHEN PER ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij ligji.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në VKM 419, datë 17.7.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja".

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANE KONTRIBUAR NE HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Agjencinë për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore për Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore dhe Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERESIMIT TE TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektvendimit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI
Mirela KUMBARO FURXHI



Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në VKM 419, datë 17.7.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja".